



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 559/1 Prot.

Tiranë, më 14 / 04 / 2021

V E N D I M

Nr. 62, Datë 14 / 04 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 49 Regj, datë 31.03.2021, të paraqitur nga N. L, kundër Departamentit të Administratës Publike, në të cilën pretendohet diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, N. L, ka pretenduar se është diskriminuar nga Departamenti i Administratës Publike (DAP), nëpërmjet procedurës së shpallur elektronikisht prej tij, me nr. 3548 “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”.

Sipas shpjegimeve të dhëna prej tij, ankuesi ka pretenduar se kriteret e përcaktuara nga DAP, lidhur me kërkesat që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Organeve Certifikues dhe Inspektues, në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit”, janë diskriminuese dhe në kundërshtim me legjislacionin shqiptar. Specifikisht, në shpalljen elektronike të bërë nga DAP, përcaktohet se:

“Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo “Master Profesional” të përfitur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor “ duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b - Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- c - Të kenë certifikime në standartet ISO / IEC 17011: 2017 “Kërkesa për trupat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit”, ISO / IEC 17024: 2012 “Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat e përgjithshme për organet e certifikimit të personave”, ISO/ IEC 17020:2012 –“Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim”, ISO/ IEC 17021-1: 2015-“Kërkesat për organet që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit “.

Ankuesi, në vijim të parashtrimeve të tij citon se:

“Në përcaktimin e kriterëve për këtë pozicion nga ana e DAP, nuk janë marrë në konsideratë:

- *Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 919, datë 25.11.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, 1 germa d, në të cilën përcaktohet: “Në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, titullari i institucionit dhe, për njësitë teknike të përmbajtjes nëpunësit civilë në pozicionet, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë”.*
- *Rregullorja Evropiane nr. 765/2008 “Kërkesa për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut në lidhje me tregtimin e produkteve”, e cila, në nenin 8 pika 3 përcakton se vendimarrësit në procedurat e akreditimit duhet të jenë kompetent. Po kështu ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton në Kreun II, nenin 9 pika 3 dhe 8 kërkon që personeli i DPA dhe vendimarrësit të jenë kompetent.*
- *Standardi ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit”, në paragrafët 6.1.2.2, 6.1.2.3, 6.1.2.4, 6.1.2.5 dhe 6.1.2.8 përcakton që vendimarrësit duhet të kenë kompetencë.*
- *Procedura, e DPA, “Menaxhimi i personelit të përfshirë në proceset e akreditimit”, Kodi DA-PM-002.*
- *Procedura e DPA, “Rekrutimi, vlerësimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, Kodi DA-PM-003, rishikimi Nr.3, datë 20.05.2019, Kapitulli 6, pika 6.1: Ngritja në detyrë dhe lëvizja paralele, në të cilën përcaktohet se, “Stafi i DPA gëzon të drejtën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë nëse është shpallur vendi vakant në këtë Drejtori. Sipas legjislacionit përpara se të fillojë procedura e pranimit në shërbimin civil, vendi i lirë u ofrohet punonjësve civil ekzistues nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe më pas në qoftë se vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë. Në rast lëvizjeje paralele dhe ngritjes në detyrë kandidatët i nënshtrohen testimit”.*

Subjekti ankues shpehet se, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të Urdhrit nr.2, datë 12.01.2021, të Kryeministrit, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit, për shkak të mbylljes, apo restrukturimit”, e ka transferuar nga Drejtoria e Akreditimit tek Drejtoria e Akreditimit të Organeve Certifikues dhe Inspektues, në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, dhe se plotëson të gjitha kërkesat ligjore për ngritjen në detyrë.

Ankuesi ka pretenduar se, kriteret e veçanta, të evidentuara në shpalljen për ngritjen në detyrë, nga ana e DAP, nuk justifikohen objektivisht nga një synim i ligjshëm, dhe kanë vënë ankuesin në kushte të pafavorshme. Ai është shprehur se plotëson të gjitha kërkesat ligjore, për ngritje në detyrë dhe kriteret e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, ndërkohë që është përjashtuar nga kjo e drejtë, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DAP.

Ankuesi ka cituar se:

“Procedura e ndjekur nga DAP, bie ndesh me ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar, i cili sanksionon se: “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”, me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe ndihem i diskriminuar në mënyrë të tërthortë, pasi kriteret e publikuara nga DAP, për këtë pozicion, më mohojnë të drejtën time të patjetërsueshme, për ngritje në detyrë”.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga KMD, konstatimin e diskriminimit nga DAP dhe anulimin e procedurës me nr. 3548 “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, të shpallur elektronikisht.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 02.04.2021, KMD, i ka kërkuar z. L të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet postës elektronike të datave: 02.04.2021, 06.04.2021 dhe 07.04.2021, subjekti ankues ka dërguar dokumentacion plotësues dhe parashtrime, por sërish nuk ka shpjeguar dhe dokumentuar shkakun për të cilin ka pretenduar diskriminimin.

Ankuesi ka parashtruar argumentat dhe pretendimet e tij, duke cituar se: *“Përjashtimi nga kriteret e miratuara më parë, nga DPA, nuk është i rastesishëm, por është vendosur për të paracaktuar fituesin, dhe për të eliminuar stafin e DPA-së të marrë pjesë në konkurim, duke favorizuar vetëm një person, i cili nuk ka përvojën e duhur 3 vjeçare, si person teknik në këto fusha.*

“Kriteri a), është vendosur për të favorizuar një person në veçanti, pasi asnjë prej nesh nuk e plotëson këtë kriter. Unë kam fakultetin Juridik, ciklin 3 vjeçar dhe kam titullin "Bachelor i Drejtësisë.", në përfundim të të cilit kam marrë 180 kredite. Kam vijuar edhe Master Shkencor në të drejten ndërkombëtare, dhe kam mbaruar cilkin e plotë të studimeve, por nuk jam diplomuar.

Në të njëjtën logjikë është vendosur edhe kriteri b), pasi vetem ajo ka mbi tre vjet punë në pozicionin e juristes, si juriste në DPA, dhe asnjëri prej nesh nuk e plotëson këtë kriter.

Ndërsa kriteri c), përcakton njohuri në fushat përkatëse, ndërkohë që duhet të jetë eksperiencia në punë, gjë e cila nuk është vendosur, pasi personi i favorizuar nuk e ka një eksperiencë të tillë”.

Tek rubrika “Shkaku për të cilin pretendohet diskriminimi” i Formularit të Ankesës është shënuar “çdo shkak tjetër”, pa asnjë shpjegim, argumentim apo dokumentacion lidhur me çfarë referon tek ky shkak subjekti ankues.

Në parashtrimet e sjella nëpërmjet e-mailit,ankuesi, ndër të tjera citon se: *“ Në formularin e ankimit, nuk kishte rubrikë për diskriminimin e tërthortë dhe për këtë arsye, nga ana ime është plotësuar rubrika “çdo shkak tjetër””.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar³, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe

³ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikojë se cili është ky shkak.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues N. L, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: “Çdo shkak tjetër”

Lloji i vendimit: Mospranim